

STATUT I SHOQERISE TREGTARE

"Deutsch Plastik" SH.P.K

Shoqeria tregtare "Deutsch Plastik" SH.P.K krijohet ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjin 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".

KREU I

Dispozita te pergjithshme

NENI I

Shoqeria '**Deutsch Plastik**' shpk eshte person juridik shqiptar.

Ajo gezon pesonalitetin juridik qe nga momenti I rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtar dhe ne Organin tatimor.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e themelimit (Akti I Themelimit dhe Statuti).

NENI 2

Shoqeria '**Deutsch Plastik**' shpk eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me seli ne adresen :

Elbasan, Labionot fushe, Rruga Elbasan-Xibrake km.13, zk.3864, pasuria nr.734/1.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 3

Afati I veprimtarise se Shoqerise do te jete I pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.



NENI 4

Emertimi I shoqerise eshte "**Deutsch Plastik**" shpk

Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korrespondence ne faturat, ne te gjithë reklamat dhe botimet e njerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala "sh.p.k" ose "Shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar" nga numri I regjistrimit te saj dhe selia.

KREU II

Objekti I veprimtarise

NENI 5

Objekt I veprimtarise se shoqerise do te jete :

- Prodhim,perpunim,tregtim I produkteve plastike.
 - Transport, import-eksport I produkteve plastike.
 - Transport per nevojat e aktivitetit.
 - Import-eksport.
- Dhe cdo aktivitet tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputje me legjislacionit Shqiptar.

NENI 6

Themeluesi I shoqerise rezervomn te drejten te modifikojë objektin e veprimtarise ne cdo kohe.

KREU III

Kapital Themeltar

NENI 7

Kapitali themeltar I shoqerise perfaqeson kontributet ne pare dhe eshte 100.000 (njqindmije) leke shqiptare. Ortaku Z.Nazif Bajrami zoteron nje kuote me vlere 50.000 leke ose 50% te kapitalit themeltar. Ortaku E&G BeteiligungsgesellschaftmbH , I pajisur me nr identifikimi /npt 327/5998/7392, adrese 48477 Horstel , Uthuiser Strabe 19,zoteron 1 kuote me vlere 50.000 leke ose 50% te kapitalit.



KREU IV

NENI 8

Ortaku ushtron kompetencat qe I jane caktuar , ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit 129/2014. Ai merr vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj.

NENI 9

Vendimet ne emer te ortakeve merren sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise. Ortaket marrin vendime per ceshtje te meposhtme :
Miratojne strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes.
Emerojne dhe shkarkojne Administratorin e shoqerise.
Administrator I shoqerise emerohet **Z.Nazif Bajrami** pajisur me numer personal **G91101005T** me kohezgjatje te mandatit per **5 vjet**.
Ndryshojne dhe modifikojne statutin e shoqerise, kapitalin themeltar e objektin e veprimtarise se shoqerise , si dhe ndryshimin e formes juridike te shoqerise.
Miratojne llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.
Vendosin per prishjen e shoqerise.
Zmadhimin dhe zvogelimit e kapitalit themeltar.
Riorganizimin, mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likuidimin e saj.
Orientimet ne baze te cilave do te drejtoje veprimet shoqeria, e do te caktojte preferancat e politikes se saj ekonomike e tregtare.
Ndermarrjen e aktiviteteve te reja afariste.
Dhenien per peng ose hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.

NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008 dhe ligjin 129/2014.

Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqerise dhe mund te kryej te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise.

Administratori perfageson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te saj me pale te tjera, me banka, shoqeri transporti, e tjere.

Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se ortakeve. Administratori qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarise se shoqerise eshte gjithashtu I detyruar te kerkoje nga asambleja e ortakeve te marre vendim per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.

Nese asambleja e ortakeve nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administratori I dorehequr, atehere administratori njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Rregjistrimit sebashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se ortakeve dhe Qendra Kombetare e Rregjistrimit rregjistron largimin e administratorit sipas procedurave te ligjit 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit te ndryshuar.

NENI 11

Ortakët emerojnë deri në dy eksperte kontabil për një periudhë kohe 6 vitesh financiare të cilët ushtrijne kontroll të veprimtarisë së shoqërisë.

Ekspertët kontabel bëjnë të gjitha verifikimet e kontrollet që gjykojnë të nevojshme, në çdo kohë të vitit dhe të dy bashkë ose veç e veç.

Ata mund të shqyrtojnë në vend të gjithë dokumentacionet e shoqërisë që e vlersojnë të dobishme në ushtrimin e detyrës së tyre.

KREU V

Veprimtaria e shoqërisë

NENI 12

Viti ekonomik financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Viti I parë financiar fillon në datën e themelimit të shoqërisë.

Pagimi I pagave, taksave dhe tatimeve dhe I kuotave për sigurimet shoqërore do të behen në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi.

NENI 13

Shoqëria do të mbajë librin e llogarise në leke dhe në valute të huaj dhe do të bëjë përlllogaritjet për nxjerrjen e bilancit në përputhje me ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

NENI 14

Emerimi dhe marrja në punë, caktimi I pages për çdo punonjës dhe largimi nga puna janë kompetencat e administratorit.

Marredheniet e punës mes shoqërisë si punëdhënese dhe punëmarrese rregullohet me kontratë e punës legjislaconin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU VI

Prishja, shperndarja dhe likujdimi

NENI 15

Shoqeria mund te shperndahet per shkaqet e meposhtme :

- a) Me vendim te asamblese se ortakeve.
- b) Me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar, pasi te jete shpenzuar dhe fondi reserve. Ne rast se ortakët nuk marrin vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- c) Me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
- d) Ne rast se objekti behet I parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare.
- e) Ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise.

Ne rastin e prishjes se shoqerise, shoqeria do te likujdohet.

Ortakët duhet te caktojne nje ose disa likuidatore.

Likujdimi I shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr 129/2014.

NENI 16

Te pakten 15 dite perpara dates se aprovimit te llogarive te shoqerise, keto llogari duhet te jene ne dispozicion te ortakeve ne seline e shoqerise.

Administratori do te percaktoje rregullat operative per ti bere te mundur ortakut konsultimin e librave te llogarive te shoqerise te pakten 2 here ne vit.

NENI 17

Persa nuk eshte parashikuar nga statuti I tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Date 19/08/2020

STATUTI I SHOQERISE "Deutsch Plastik" SH.P.K

ORTAKET

Nazif Bajrami

E&G Beteiligungsgesellschaft mbH, I pajisur me nr identifikimi 327/5998/739

44